



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE

УСТАВНИ СУД

CONSTITUTIONAL COURT

SEKRETARIA / SEKRETARIJAT / SECRETARIAT

Prishtinë, më 27 qershor 2012

Nr. ref.: RK261/12

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

**Rastin Nr. KI130/10**

Parashtruesja

**Cyma Agović**

**Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës  
Supreme të Kosovës, ASC-09-0045, të 8 marsit 2010**

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Ivan Čukalović, gjyqtar  
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe  
Iliriana Islami, gjyqtare

#### Parashtruesja e Kërkesës

1. Parashtruese e kërkesës është znj. Cyma Agović me vendbanim në Pejë.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesja e konteston aktgjykimin e Panelit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: “Paneli i Ankesave”), ASC-09-0045, të 8 marsit 2010, të cilin parashtruesja e ka pranuar më 22 mars 2010.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes së lëndës së parashtruar më 28 dhjetor 2010, në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: “Gjykata Kushtetuese”) është vlerësimi i Kushtetutshmërisë së aktgjyimit të Panelit të Ankesave, ASC-09-0045, të 8 marsit 2010.
4. Parashtruesja pretendon se vendimi i lartpërmendur shkel të drejtat e saj të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: “Kushtetuta”), më saktë neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike], neni 46 [Mbrojtja e Pronës], neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit], neni 51 [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale], neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] si dhe neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare].

## **Baza juridike**

5. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 15 janarit 2009, (Nr. 03/L-121), (në tekstin e mëtejme: “Ligji”), dhe rregulli 56.2 i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: “Rregullorja”).

## **Procedura në Gjykatë**

6. Më 28 dhjetor 2010, parashtruesja dorëzoi Kërkesën në Gjykatë.
7. Më 14 shkurt 2011, Kryetari, me vendimin Nr. GJR 130/10, e caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu Gjyqtar raportues. Të njëjtën datë, Kryetari, me vendimin Nr. KSH. 130/10, e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Snezhana Botusharova (kryesuese), Ivan Čukalović dhe Iliriana Islami.
8. Më 27 janar 2011, Gjykata njoftoi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe Agjencinë Kosovar të Privatizimit.
9. Më 18 qershor 2012, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës për papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

10. Parashtruesja ka punuar në lavanderi të Hotelit Rugova në Pejë nga viti 1978 deri në vitin 1999.
11. Më 3 shtator 2003, Drejtorja e Hotelit Rugova në Pejë kishte përpiluar listën e punëtorëve të kualifikuar që kanë të drejtë në 20% e mjeteve nga privatizimi i ndërmarrjeve publike, dhe e njëjta ishte përcjellë në Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (në tekstin e mëtejme: “AKM”) për procedim. Parashtruesja kishte qenë e përfshirë në atë listë.
12. Më 7, 8, 10 dhe 11 maj 2008, AKM-ja kishte publikuar listën përfundimtare të punëtorëve të kualifikuar për realizimin e 20 % të mjeteve të realizuara nga privatizimi

i ndërmarrjes në fjalë, dhe kishte potencuar që afati i fundit për paraqitjen e ankesave ishte 2 qershor 2008. Parashtruesja nuk ishte në këtë listë.

13. Më 6 maj 2009, parashtruesja ankohet në Trupin Gjykses të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejme: "Trupi Gjykses") pasi që parashtruesja nuk ishte e përfshire në listën e hartuar nga AKM-ja.
14. Më 9 korrik 2009, Trupi Gjykses hidhi poshtë ankesën e parashtrueses duke bazuar në seksionin 10.6 (a) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2003/03 mbi transformimin e së drejtës për përdorimin e pronës së patundshme në pronësi shoqërore (në tekstin e mëtejme: "Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2003/13"), sepse afati për paraqitjen e ankesave kishte skaduar, d.m.th. 2 qershor 2008 (Aktvendim SCEL-08-003-0102).
15. Më 12 gusht 2009, parashtruesja kishte dorëzuar një ankesë tek Paneli për Ankesa, ku kërkonte që të hidhet poshtë Aktvendimin e Trupit Gjykses, SCEL-08-003-0102, dhe kërkoi kthimin në gjendjen e mëparshme sepse parashtruesja ishte e shtrirë në spital, 4 deri më 14 prill 2008, prej 28 maj deri më 28 maj 2009 si dhe më 29 maj, në kohën kur është dashur të paraqitet ankesa kundër listës përfundimtare të AKM-së.
16. Më 8 mars 2010, Paneli i Ankesave hidhi poshtë ankesën e parashtrueses dhe vërtetoi aktvendimin e Trupit Gjykses (aktgjykimi ASC-09-0045). Paneli i Ankesave theksoi se aktvendimi i Trupit Gjykses, SCEL-08-003-0102, ishte i drejtë pasi që parashtruesja kishte paraqitur ankesën kundër listës përfundimtare të AKM-së pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, pas mbarimit të afatit për parashtrimin e ankesave. Gjithashtu edhe kërkesa e parashtrueses për kthim në gjendje të mëparshme u hidh poshtë për shkak që, propozimi për kthimin në gjendje të mëparshme sipas nenit 118 të Ligjit për Procedurën Kontestimore ("Gazeta zyrtare e RSFJ", Nr. 4/77-1478, 36/80-1182, 69/82-1596) është dashur të paraqitet brenda pesëmbëdhjetë dite duke llogaritur që nga dita kur ka pushuar arsyeja që ka shkaktuar ometimin, respektivisht deri më 3 shtator 2008.
17. Më 12 gusht 2010, parashtruesja kishte dërguar një letër të Kryesuesi i Misionit të EULEX-it, ku kishte kërkuar që edhe një herë të rishikohet aktgjykimi ASC-09-0045 i Panelit të Ankesave, i cili sipas saj nuk ishte i drejtë.
18. Më 30 shtator 2010, Kryesuesi i Misionit të EULEX-it, ishte përgjigjur në shkresë duke theksuar se EULEX-i nuk ka mandat dhe as autoritet që të shqyrtojë vendimet e organeve gjyqësore. Mirëpo pasi që parashtruesja kishte vënë në pikëpyetje korrektësinë dhe drejtësinë e stafit të EULEX-it, Kryesuesi i Misionit të EULEX-it ankesën e 30 shtatorit 2010 e kishte drejtuar tek Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut.
19. Më 8 dhjetor 2010, Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut gjeti ankesën e parashtrueses si të pabazuar për shkak se Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut në bazë rregullit 25, paragrafi 1 të Rregullores së Punës të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut nuk ka juridiksion për ta shqyrtuar procedurat juridike që janë kryer nga gjykatat e Kosovës.

### **Pretendimet e parashtrueses**

20. Parashtruesja pretendon se me aktgjykimin e Panelit të Ankesave, ASC-09-0045, të 16 marsit 2010, i janë shkelur të drejtat e saj të garantuara me Kushtetutë, pasi që parashtrueses iu është mohuar drejta e marrjes së 20% të mjeteve pas privatizimit të ndërmarrjes në të cilën ajo kishte punuar për më shumë se 20 vite dhe për shkak se Paneli i Ankesave gjatë gjykimin të rastit nuk e kishte marrë parasysh gjendjen e sajë

shëndetësore në të cilën ajo kishte qenë gjatë kohës kur është dashur të parashtrohet ankesa kundër listës përfundimtare të AKM-së.

### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

21. Gjykata vëren se, për të gjykuar për kërkesën e parashtrueses, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesja i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregulloren e punës.
22. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit që përcakton se:

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht.”*
23. Nga dokumentet e parashtruara, duket që kërkesa nuk është parashtruar brenda afatit kohor sipas nenit 49 të Ligjit, sepse aktgjykimi, ASC-09-0045 i 8 marsit 2010, i Panelit të Ankesave është pranuar nga parashtruesja më 22 mars 2010. Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesja ka parashtruar kërkesën në Gjykatë më 28 dhjetor 2010.
24. Përveç kësaj, parashtruesja i ka dërguar letër Kryesuesit të Misionit të EULEX-it më 30 shtator 2010, dhe më 8 dhjetor 2010, Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut gjeti ankesën e parashtrueses si të pabazuar. Në këtë drejtim, Gjykata dëshiron të ritheksojë gjetjet e saj në Rastin KI 64/11, të 14 shkurtit 2012, në të cilin përcaktoi që: “letra i dërguar Kryesuesit të Misionit të EULEX-it nuk është mjet juridik i paraparë me ligj dhe nuk ka e ka fuqinë të ndikojë në aktgjykimin e Gjykatës Supreme” (shih Rastin nr. KI 64/11, Feti Gashi, Vlerësimi i kushtetutshmërisë të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Nr. 184/2008 të 27 janarit 2009, Aktvendim për Papranueshmëri, të 3 marsit 2011).
25. Gjithashtu, në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane, parashtruesit janë vetëm të obliguar t'i shterojnë mjetet juridike që janë në dispozicion në teori dhe në praktike në kohën përkatëse, pra, mjetet që janë të qasshme, që sigurojnë kompensim lidhur me ankesat e tyre dhe që ofrojnë mundësi të arsyeshme për sukses (Aktgjykim i Dhomës së Madhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin Sejdivic kundër Italisë, Kërkesa nr. 56581/00 e 1 marsit 2006, paragrafi 46).
26. Prandaj, Gjykata konkludon që Kërkesa nuk është parashtruar brenda afatit kohor sipas nenit 49 të Ligjit.
27. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 36 të Rregullores së Punës së Gjykatës që përcakton se:

*“(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) Kërkesa është qartas e bazuar:”*
28. Para së gjithash, parashtruesja nuk i parashtroi ankesë në Trupin Gjyqësor brenda afatit ligjor.
29. Në fakt, Paneli i Ankesave konkludoi se parashtruesja nuk e ka parashtruar ankesën e saj brenda afatit ligjor të paraparë me seksionin 10.6 (a) Rregullorja e UNMIK-ut 2003/13 dhe neni 118 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (“Gazeta zyrtare e RSFJ”, Nr. 4/77-1478, 36/80-1182, 69/82-1596).

30. Parimi i subsidiaritetit parasheh që parashtruesja të shterë të gjitha mundësitë procedurale në procedurat e rregullta, në mënyrë që t'i parandalojë shkeljet e Kushtetutës, ose, nëse ka, të korrigjojë shkelje të tilla të të drejtave themelore. Kështu që, parashtruesja duke dështuar për të ndërmarrë veprime procedurale në gjykatat e rregullta në pajtim me afatet e parapara, faktikisht, mban përgjegjësinë pse rasti i saj deklarohet i papranueshëm, meqë do të kuptohet si heqje dorë nga e drejta për procedim të mëtejshëm për të kundërshtuar shkeljen.
31. Gjykata gjithashtu konsideron se dyshimi i thjeshtë mbi perspektivën e çështjes nuk është i mjaftueshëm për të ndaluar parashtruesen nga detyrimet e saj për t'u ankuar para organeve kompetente në kohën e duhur (shih Whiteside kundër Mbretërisë së Bashkuar, Vendimi i 7 marsit 1994, parashtrësja nr. 20357/92, DR 76, fq.80).
32. Në vazhdim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të merret me gabimet e fakteve ose ligjit (ligjshmërisë) gjoja të kryera nga ana e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, përveç nëse dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Kështu që, Gjykata nuk duhet vepruar si gjykatë e shkallës së katërt, kur shqyrtohen vendimet e marra nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat e caktuara të të drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
33. Si përfundim, Gjykata mund vetëm të vlerësoi nëse dëshmitë janë paraqitur në mënyrë të tillë, dhe nëse procedurat në përgjithësi, porë si tërësi, janë kryer në atë mënyrë që parashtruesja ka pasur gjykim të ndershëm (shih mes tjerash, Raportin e Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, App. Nr. 13071/87, miratuar më 10 korrik 1991).
34. Për më tepër, parashtruesja thjeshtë konteston nëse Dhoma e Posaçme të Gjykatës Supreme ka zbatuar plotësisht ligjin në fuqi dhe nuk pajtohet me gjetjet faktike të gjykatave lidhur me rastin e saj.
35. Në të vërtetë, parashtruesja nuk i ka mbështetur pretendimet e saj në baza kushtetuese dhe nuk ka ofruar ndonjë dëshmi se të drejtat dhe liritë e saj janë shkelur nga autoritetet publike. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të përfundojë se procedurat relevante në çfarëdo mënyre ishin të padrejta apo arbitrare (shih *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, GJEDNJ Vendimi për Pranueshmëri Nr. 17064/06 i 30 qershorit 2009).
36. Në fakt parashtruesja përpos shprehjes së mos kënaqësisë për aktgjykimin e Panelit të Ankesave, ASC-09-0045, të 8 marsit 2010, nuk ka argumentuar në mënyrë bindëse se pse gjykimi “nuk ka qenë i drejtë dhe i paanshëm” se në cilën mënyrë ajo ka qenë e trajtuar si e pabarabartë apo cila fazë e procedurës ka qenë kundër kushtetuese.
37. Nga kjo rrjedh se kërkesa është e papranueshme për arsye të parashtrimit të kërkesës jashtë afatit dhe, edhe sikur Kërkesa të ishte brenda afatit, Kërkesa është qartazi e papabazë në pajtim me rregullin 36 (1.c) të Rregullores së punës.


## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në bazë të nenit 49 të Ligjit dhe Rregullit 36 (1.c) dhe 56 (2) të Rregullores më 18 qershor 2012, njëzëri,

## VENDOS


- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari Raportues**



Mr. sc. Kadri Kryeziu

**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**



Prof. dr. Enver Hasani